

Ftesë për ofertë

Titulli: “Ofertë për blerje të veturave”

Data e hapjes për ofertim: 20/05/2025

Data e mbylljes për ofertim: 03/06/2025

Institucion Mikrofinanciar Agjencioni për financim në Kosovë –AFK, fton kompanitë shitëse të interesuara të paraqesin ofertat për “Blerje të veturave”, karakteristikat e veturave janë si në vijim:

1. Informata të përgjithshme:

- Vetura të udhëtarëve
- Lënda djegëse- Dizel /Benzinë
- Lloji I frenimit ABS
- Numri I dyerve 4/5
- Lloji I mbylljes -Qendrore
- Niveli I paisjes standard (bazike)
- Me klimatizim

2. Kërkesat për ofertat financiare:

- Ju lutemi që ofertën tuaj ta dorëzoni tek zyrja e AFK-së në pajtim me specifikat e parashtruara në Shtojcën 1 të këtij dokumenti.
- Të gjitha ofertat të dorëzohen në Euro, përfshirë TVSH-në, në të kundërtën në rast se çmimet dorëzohen pa e specifikuar TVSH-në, AFK do të konsiderojë se çmimet përfshijnë TVSH-në.

3. Kushtet e përgjithshme:

Oferta duhet të përmbajë informatat në vijim:

- Adresa e plotë dhe detajet kontraktuese të ofertuesit;
- Të përmbajë numrin e ofertës dhe datën e ofertës;
- Ofertën e specifikuar me foto dhe specifika të veturave;
- Çdo faqe e ofertës duhet të vuloset dhe të nënshkruhet nga personi i autorizuar;
- Ofertës duhet t’i bashkangjitet Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe Çertifikata e numrit Fiskal (kopje).

4. Kushtet dhe rregullat e tenderit:

- Dokumentet duhet të vendosen në një zarf të mbyllur dhe të dorëzohen në zyret e AFK-së;
- AFK do të pranojë vetëm ofertat e juaja të mbyllura në zarf, dhe nuk do të konsideroj asnjë formë tjetër të aplikimit.

- AFK nuk mban përgjegjësi për dëmtimin , humbjen apo mos pranimin e ofertave.
- Vlefshmëria e ofertës së paku një muaj.

Ofertat duhet të dërgohen të mbyllura në zarf me mbishkrimin ***“Ofertë për blerje të veturave”*** në adresën e zyrës qendrore të AFK-së në Pejë : Rruga “Lidhja e Prizrenit Nr.20” 30 000.

Afati i fundit i pranimin të ofertave 03/06/2025 ora 16:00.

AFK mbanë të drejtën e anulimit ose të ndryshimit të shpalljes në çdo kohë.